



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 7 dhe nenit 23 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit duke vepruar për denoncimin me akuza për ekzistim të konfliktit të interesave nga parashtrues i njohur, në seancën e 47 të mbajtur me datë 31.03.2021 morri

VENDIM

Procedura e ngritur për vërtetim të gjendjes së konfliktit të interesave pas denoncimit me nr. 09-5683/1 me datë 19.12.2019 dorëzuar nga parashtrues i njohur, NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit konstaton se nuk janë vërtetuar akuzat nga denoncimi dhe përfundon se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për lëndën me numër 09-5683/1 me datë 19/12/2019.

Lënda me numër 09-5683/1 me datë 19.12.2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

SQARIM

Lënda me numër 09-5683 me datë 12.19.2019 është e formuar në bazë të denoncimit nga parashtrues i njohur, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, kundër personit nëpunës shtetëror, i vendosur në vendin e punës Udhëheqës i sektorit në Ministrinë e

Në denoncim theksohet se nëpunësi shtetëror i vendosur në vendin e punës Udhëheqës në sektorin e Ministrisë së mbanë trajnime komerciale me ndërmarrje private si dhe në shtojcë të denoncimit është ftesa publike dhe agjenda e trajnimit e organizuar nga Qendra për trajnime "Akademik" dhe është mbajtur me datë 23.12.2019 nga ora 10.00 deri në ora 14.30, në temën "Aplikimi praktik i Ligjit për subvencionim të të ardhruave sociale si rezultat i rritjes së rrogës nga data 19.11.2019.

..... theksohet si një nga ligjëruesit me status Udhëheqës në Sektorin për politika nga fusha e në Ministrinë e

Me qëllim të përcaktimit të gjendjes faktike dhe vërtetimit të akuzave në denoncim, Komisioni shtetëror u drejtuar deri tek Ministria e dhe dorëzoi Kërkesë për mbledhje të të dhënave dhe informacioneve.

Në afatin e caktuar me ligj është dorëzuar përgjigje nga Ministria e dhe shtojcë vendim për vendosje të personit të përmendur me të cilën me datë 06.07.2017 vendoset në vendin e punës Udhëheqës i Sektorit për politika nga fusha e në Ministrinë për, kurse në lidhje me çështjet tjera nga kërkesa e KSHPK theksohet se në dosjen personale të të punësuarës nuk ka autorizim për mbajtje të trajnimimeve, nuk ka listë të trajnimeve dhe kompenzime për të njëjtat dhe listë për trajnimet e mbajtura nga personi i përmendur nëpërmjet personave të jashtëm juridik për vitin 2019.

Përgjigje për kërkesën e parë për të dhënat dhe informacionet është e nënshkruar nga ministresha e atëhershme

Nga të dhënat e pamjaftueshme të dorëzuara për të gjitha çështjet për kërkesën e parë, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit u drejtua përsëri deri tek Ministria për me kërkesë për të dhëna shtesë dhe informacione.

Me datë 15.02.2021 është dorëzuar përgjigje me shtojcë dokumentacion dhe shprehje për të gjitha çështjet nga kërkesa e KSHPK.

Në shtojcë të përgjigjeve është dorëzuar përsëri vendimi për vendosje në vendin e punës të personit të përmendur me të cilën dallon nga e para dhe mbanë datën e 22.05.2019 nga e cila vërehet se personi i përmendur është i vendosur në vendin e punës nëpunës në kabinet për politika për punësime,

Nga ajo vërehet se personi i përmendur është i vendosur në vendin e punës me titullin nëpunës (zyrtarë) kabinetit dhe parase të dorëzohet përgjigja e parë për kërkesën e KSHPK nënshkruar nga Ministresha në qeverinë teknike por nuk është treguar dhe dorëzuar në shtojcën e përgjigjes, dhe është dorëzuar vendimi paraprak për punësim në vendin e punës me titullin udhëheqës i sektorit.

Ajo që ka të bëjë me akuzat e denoncimit konstatohet se personi i përmendur mbanë trajnime komerciale me ndërmarrje private dhe me këtë shkelë dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe më së paku bëhet fjalë për konflikt të interesave kurse në shtojcë është dorëzuar ftesa publike dhe agjenda e trajnimit e organizuar nga Qendra për trajnime "Akademik" e cila është mbajtur me datë 23.12.2019 me fillim nga ora 10.00 deri në 14.30, me temën "Aplikimi praktik i Ligjit për subvencionim të të ardhurave sociale si rezultat i rritjes së rrogës nga data 19.11.2019, në përgjigjen e prësëritur nga sqarojnë se me datë 19.01.2019 deri tek Qendra për trajnime Akademik kanë marrë kërkesë e cila është dorëzuar në shtojcë të përgjigjes dhe ka të bëjë me nominimin e personit si ligjërues në trajnimin për për më tepër trajnime duke filluar nga data 22.01.2019 deri në 25.12.2019.

Me përgjigjen është dorëzuar edhe raport për mungesën nga orari i punës gjatë kohës së mbajtjes së trajnimeve me kohën hyrës dhe dalëse zyrtare nga hapsirat e punës.

Në lidhje me autorizimin për persona për mbajtje të trajnimeve për persona të jashtëm nga shprehen se praktikë e tillë nuk është e vendosur, dhe se për kompensim të personit të punësuar për mbajtje të trajnimeve me kërkesë nga institucione tjera për nominim, gjithashtu nuk ekzistonë praksë e tillë në nuk është paguar kompenzim për personin e përmendur dhe se nuk është paguar kompenzim për personat e nominuar për mbajtje të trajnimeve.

Pas shqyrtimit të përsëritu të përmbajtjeve në denoncim, si dhe në informacionet e dorëzuara Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit përfundon se akuzat nuk janë vërtetuar dhe nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent.

Duke pasë parasyshë të shënuarën mësipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave të këtij vendimit.

**KOMISIONI SHTETËRORE PËR
PARANDALIM TË KORRUPSIONIT**

Крыетарë: Biljana Ivanovska

Pas përfundimit të senacës së KSHPK
Përpunoi: B. Xh., këshilltarë
Miratoi: N. B., anëtarë i KSHPK
Dorëzuar deri tek: Arkiva, Parashtruesi

